



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE
RAPORTIMIT FINANCIAR
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 18147 Prot.,

Tiranë më 22.12.2025

URDHËR

Nr. 159, datë 22.12.2025

**“PËR
HAPJEN E PROCESIT TË CERTIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM
NË SEKTORIN PUBLIK, PËR SEZONIN 2026”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 19, të ligjit Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 9 pika 1 e Rregullores për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit të certifikimit për “Auditues të Brendshëm në Sektorin Publik”, për sezonin 2026.
2. Në procesin e aplikimit për auditues të brendshëm në sektorin publik, do të kandidojnë:
 - a) punonjësit e njësive të auditimit brendshëm në sektorin publik, të pa certifikuar;
 - b) nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë, që kanë përvojë pune 3 vjet në profesion apo kryejnë detyra publike ose akademike në disiplina të tilla, si auditimi i brendshëm, sigurimi i cilësisë, menaxhimi i riskut, inspektimi, përputhshmëria, auditimi i jashtëm dhe kontrolli i brendshëm.
3. Numri maksimal i kandidatëve pjesëmarrës është deri në 200 (dyqind) persona.
4. Kandidatët për certifikimin si auditues të brendshëm në sektorin publik, duhet të paraqesin në formë shkresore në Ministrinë e Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) kërkesë me shkrim;
 - b) curriculum vitae;
 - c) fotokopje të diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë të noterizuar;

- d) fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
 - e) vërtetim punësimi mbi përcaktimin e pozicionit të punës;
 - f) certifikatën e gjendjes gjyqësore.
5. Hapjen e procedurës së aplikimeve për trajnerë të certifikimit për “Auditues të Brendshëm në Sektorin Publik”.
 6. Komisioni, përcakton numrin e nevojshëm të trajnerëve dhe i përzgjedh ata, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 7 të këtij urdhri.
 7. Trajnerët e kategorisë së parë duhet të plotësojnë një nga kërkesat e mëposhtme:
 - a) diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe 6 deri 10 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
 - b) diplomë postmaster apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
 8. Trajnerët e kategorisë së dytë, duhet të plotësojnë një nga kërkesat e mëposhtme:
 - a) diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe mbi 10 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
 - b) Gradë apo titull shkencor dhe minimalisht 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
 9. Trajnerët e kategorisë së parë dhe trajnerët e kategorisë së dytë duhet të plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme:
 - a) Njohuri të mira të standardeve profesionale të auditimit të brendshëm dhe të kenë përvojë praktike në fushën e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
 - b) Aftësi për të hartuar një program mësimor në lidhje me temat e moduleve dhe ta prezantojë atë në një mënyrë sa më të qartë përpara auditorit.
 - c) Aftësi për të shpjeguar në një mënyrë të thjeshtë përmbajtjen e programit të certifikimit;
 - d) Aftësi për t’ju përgjigjur pyetjeve dhe komenteve të bëra nga pjesëmarrësit, duke përdorur shembuj praktikë;
 - e) Aftësi për të zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore;
 - f) Të kenë përkushtimin e duhur për të këshilluar kandidatët gjatë gjithë procesit të certifikimit;
 - g) Të kenë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi.
 10. Kandidatët për trajner, duhet të paraqesin në formë shkresore në Ministrinë e Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) kërkesë me shkrim;
 - b) curriculum vitae;
 - c) referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në auditimin e brendshëm;
 - d) fotokopje të noterizuar të diplomave;
 - dh) rekomandime ose certifikata që vërtetojnë eksperiencën profesionale, aftësitë pedagogjike, si dhe integritet moral dhe reputacion të mirë;
 - e) certifikatën e gjendjes gjyqësore.

11. Pranimi i dokumentacionit për kandidatët që aplikojnë për auditues të brendshëm në sektorin publik dhe për trajner, do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike, nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
12. Kandidatët që aplikojnë për auditues të brendshëm dhe për trajner, dorëzojnë dokumentacionin në zyrën e protokollit në Ministrinë e Financave.
13. Pas marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, kryen vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat formale.
14. Lista e kandidatëve së bashku me dokumentacionin shoqërues, i përcillet për vendimmarrje Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik.
15. Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, shpall listën emërore të kandidatëve për certifikim “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” dhe për trajner.
16. Mbikqyrësit e procesit të provimeve për certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik, caktohen nga Nëpunësi i Parë Autorizues me propozim të Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.
17. Me trajnerët dhe mbikqyrësit e përzgjedhur, Nëpunësi i Parë Autorizues lidh kontratë individuale sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.116, datë 17.02.2016 “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjes së komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”, i ndryshuar.
18. Kandidatët e përzgjedhur për t’u certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” brenda 15 ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës emërore të kandidatëve, duhet të kryejnë pagesën e tarifës për procesin e certifikimit si auditues të brendshëm, në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë, në numrin e llogarisë së Ministrisë së Financave **7111003**. Mos kryerja e pagesës përbën kusht për skualifikimin e kandidatit.
19. Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Financave, të marrë masat e nevojshme për krijimin e kushteve për zhvillimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm.
20. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Financave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.

MINISTRI

Petrit Malaj

